



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

KONTRATË PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

e lidhur ndërmjet:

Ministrisë së Drejtësisë

dhe organizatës Jo-Qeveritare:

xxxxxx

në kuadër të:

PROJEKTIT / PROGRAMIT (emri): **Thirrje publike për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve në fushën e shërbimeve sociale**

KUSHTET E KONTRATËS

Neni 1

Emri i projektit / programit të financuar: „**xx**”

Vlera totale e kontratës në Euro: **xx** Euro (me fjalë: xx)

Periudha e zbatimit të projektit është **xx** (x) muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.

Linja buxhetore: xx

Referenca/numri i kontratës _____

Neni 2

1. Mjetet nga neni 1 i kontratës mund të përdoren vetëm për zbatimin e projektit, në përputhje me kushtet e thirrjes publike dhe të formës përshkuese të projektit dhe formularit të buxhetit të projektit, të cilat konsiderohen pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
2. Transferi i mjeteve financiare nga ofruesi i mbështetjes financiare tek përfituesi bëhet përmes llogarisë bankare, në dy këste:
 - 2.1. Kësti parë i transferit përfshinë xx% (**xx**) të vlerës së përgjithshme të financuar nga ofruesi i mbështetjes financiare.
 - 2.2. Kësti i dytë i transferit përfshinë xx% (**xx**) e mbetur të vlerës së përgjithshme të financuar nga ofruesi i mbështetjes financiare.
 - 2.3. Kësti i dytë do të paguhet vetëm pasi përfituesi do të dorëzon raportin e ndërmjetëm financiar dhe narrativ siç është përshkruar në Nenin 4.
 - 2.4. Në rast se përfituesi i mbështetjes nuk i përmbahet kushteve të raportimit sipas Nenit 4, atëherë ofruesi i mbështetjes financiare nuk do të bëjë transferin e dytë të shumës prej 10%, si dhe ofruesi i mbështetjes financiare do të veprojë konform Nenit 9 të kësaj kontrate.

Neni 3

Mjetet nga neni 1 do të paguhën në llogarinë bankare të përfituesit: **xx** në **xx**,

Neni 4

1. Për të kontrolluar përdorimin e duhur të burimeve përfituesi është i detyruar të dorëzojë raportet e ndërmjetme (periodike) narrative dhe financiare dhe përfundimtare narrative dhe financiare tek ofruesi i mbështetjes financiare për zbatimin e projektit i cili duhet të përfshijnë:
 - 1.1 Raportin narrativ (të cilin e dorëzon në formë të shtypur, përmes postës, dhe/ose në formë elektronike me e-mail ose me postë në një CD, DVD ose USB-në, apo formë tjetër elektronike sipas kërkesës)
 - 1.2 Raporti financiar (të cilin e dorëzon në formë të shtypur përmes postës, dhe/ose në formë elektronike me e-mail ose me postë në një CD, DVD ose USB-në apo formë tjetër sipas kërkesës) me dokumentacion të detajuar të të gjitha kostove dhe anekset:
 - a) Për pagesat e kryera me transaksione bankare: kopjet e faturave, emrin e përfituesit dhe llogari bankare përkatëse;
 - b) për pagesat në para të gatshme: kopjet e faturave, emrin e përfituesit, kopje të dëftesës së pagesës nga arka, raportet e parasë së gatshme.
 - c) dokumente të tjera: dokumente tjera të ndërlidhura me udhëtimet, agjendat, dhe të ngjashme, i bashkëngjitni dosjet shoqëruese, dokumentet mbi të cilat pagesat janë kryer (kontratat, marrëveshjet) dhe të ngjashme.
2. Anekset tjera lidhur me zbatimin e projektit, dëshmi të implementimit të aktiviteteve të projektit përfshirë (listat e pjesëmarrësve, fletët e vlerësimit, fotografi nga ngjarjet, kopje të botimeve, etj).

3. Përfituesi duhet të dorëzoj një (1) raport xx NARRATIV dhe FINANCIAR dhe Raportin Përfundimtar NARRATIV dhe FINANCIAR mbi zbatimin e aktiviteteve në afat prej: 15 ditë kalendarike / pas skadimit të periudhës së raportimit. Raportet duhet të dorëzohen tek financuesi sipas formularëve të paraparë.

Neni 5

1. Ofruesi i mbështetjes financiare rezervon të drejtën për monitorimin dhe vlerësimin e ekzekutimit të projektit, duke përfshirë shqyrtim të shpenzimeve financave dhe shpenzimeve të vazhdueshme në çdo kohë gjatë projektit dhe për një periudhë prej 5 vite pas përfundimit të projektit.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare mund të bëjë drejtpërdrejtë kontrollin e mësipërm të kësaj kontrate përmes një vizitë pune në ambientet e përfituesit, dhe në rast të kontrollit të tillë do të njoftoj përfituesin të paktën shtatë (7) ditë para kontrollit të tillë.

Neni 6

Ofruesi i mbështetjes financiare ka të drejtë që për qëllim të mbikëqyrjes së përdorimit të fondeve sipas qëllimit nga neni 1 i kësaj kontrate të kontaktoj direkt gjithë personat juridik dhe fizik të cilët janë paguar nga fondet e projektit, sipas dokumenteve të raportuar nga përfituesi i mbështetjes financiare publike.

Neni 7

1. Përfituesi merr përsipër të njoftojë në kohë ofruesin e mbështetjes financiare për ndryshimet e vogla dhe të mëdha në kontratë.
 - 1.1 Ndryshime të vogla në kontratë që nuk kërkojnë ndryshimin e kontratës përmes shtojcave, por vetëm me njoftim me shkrim nga përfituesi tek ofruesi i mbështetjes financiare, mund të jenë:
 - a) Ndryshime në buxhet brenda kategorisë së njëjtë buxhetore të buxhetit në më pak se 10%
 - b) Ndërrimi i një anëtari të ekipit të projektit
 - c) Ndryshimi i llogarisë së bankare të anëtarëve të projektit
 - d) Ndryshimi adresës ose të dhënave tjera të anëtarëve të projektit
 - e) Ndryshime të vogla në projektet që nuk ndikojnë në qëllimin dhe objektivat (psh. ndryshime të vogla në kohën e implementimit të aktiviteteve)
 - 1.2 Ndryshimet më të mëdha të kontratës kërkojnë ndryshimin e kontratës përmes një shtojce dhe nënshkrimit e saj nga ofruesi i mbështetjes financiare dhe përfituesi. Ndryshimet më të mëdha në kontratë mund të jenë:
 - a) Ndërrimet në buxhet brenda kategorisë së njëjtë të buxhetit prej më shumë se 10%

- b) Ndërrimet në buxhet në mes të kapitujve/kategorive të ndryshme buxhetore, pa marrë parasysh nivelin e përqindjes (%) së ndryshuar
 - c) Zgjatjen e kohës së implementimit të projektit (maksimumi 6 muaj)
 - d) Shtimi i aktiviteteve të reja në kuadër të projektit
 - e) Ndryshimi i aktiviteteve që në mënyrë të konsiderueshme ndikojnë në qëllimin dhe objektivat e projektit.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare vendosë në çdo rast nëse do të pranoj ndryshimin e kontratës ose jo, dhe nëse ndryshimi përbënë ndryshim të vogël ose të madh të kontratës.

Neni 8

1. Përfituesi mund të kërkojë ndryshimet në kontratë të paktën 30 ditë përpara përfundimit të projektit. Çdo ndryshim i detyrimeve kontraktuale duhet të kërkohet dhe të miratohet me shkrim. Kontrata nuk mund të ndryshohet apo plotësohet nëse qëllimi apo efekti i ndryshimit e cenon konkurrencën apo trajtimin e barabartë sipas thirrjes publike.
2. Përfituesi nuk mund të kërkoj ndryshimin e dispozitave të kontratës pas përfundimit të periudhës së implementimit të projektit, siç është paraparë në nenin 1.
3. Ofruesi i mbështetjes financiare publike ka të drejtë të mos e miratoj dhënien e një pjese të fondeve dhe zgjatjen e periudhës së zbatimit të projektit nëse kjo ndryshon përmbajtjen dhe natyrën e projektit, ose në qoftë se kërkesa nuk ka bazë dhe arsye objektive për ndryshim të kontratës ose zgjatje të periudhës së zbatimit të projektit.
4. Vendimi për miratimin ose mosmiratimin e kërkesës për ndryshim të kontratës apo zgjatje të periudhës së zbatimit të projektit duhet të merret brenda 30 ditësh nga data e kërkesës së përfituesit.

Neni 9

Nëse ofruesi i mbështetjes financiare përcakton se përfituesi është duke përdorur në mënyrë të papërshtatshme fondet e mbështetjes financiare për implementimin e projektit sipas kushteve të nenit 1 dhe 2 të kësaj kontrate dhe kushteve të kësaj kontrate, ose ka dështuar të zbatojë projektin brenda afatit të kontraktuar, në qoftë se nuk ka paraqitur raportet e duhura në kohë dhe me përmbajtjen e përcaktuar në nenin 4 të kontratës, ose nuk i ka lejuar ofruesit të mbështetjes financiare mbikëqyrjen e përdorimit të fondeve sipas nenit 5 dhe 6 të kontratës, pagesat e mëtejshme do të pezullohen, dhe përfituesi është i detyruar të kthej mjetet e shpenzuara në mënyrë të papërshtatshme dhe mjetet ende të pashpenzuara, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim për kthimin e mjeteve nga ofruesi i mbështetjes financiare.

Neni 10

Nëse ofruesi i mbështetjes financiare përcakton se përfituesi nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale, do të mohohet e drejta për të përfituar mbështetje financiare në dy vitet e ardhshme.

Neni 11

1. Përfituesi pranon që në të gjitha materialet e shtypura, video dhe materiale të tjera që lidhen me projektin të vendos logon dhe emrin e ofruesit të mbështetjes financiare si një institucion që financon projektin i cili është objekt i kontratës.
2. Përfituesi pajtohet që t'i dorëzoj ofruesit të mbështetjes financiare për përdorim dhe publikim fotot, video dhe të dhënat audio të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, për të promovuar thirrjen publike dhe për të kontribuar në zhvillimin e shoqërisë civile në Republikën e Kosovës.

Neni 12

Ofruesi i mbështetjes financiare nuk është përgjegjës, drejtpërdrejt apo tërthorazi, për dëmet që rrjedhin nga çdo veprimtari e përfituesit në zbatimin e projektit.

Neni 13

Me nënshkrimin e kësaj kontrate përfituesi pajtohet që si përfitues i burimeve publike të financimit për projektet me interes dhe në të mirën e publikut, nuk do të marrin pjesë në promovimin e ndonjë interesi privat, aktiviteti politik, fetar, apo mbështetje për ndonjë parti politike a kandidat të pavarur gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj kontrate.

Neni 14

Në rast se paraqiten mosmarrëveshje në zbatimin e kësaj kontrate në mes të palëve kontraktuese dhe nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim dhe diskutime të ndërsjella, kompetente për zgjidhjen e kontestit të tillë do të jetë gjykata kompetente në Prishtinë.

Neni 15

Për çështjet që nuk janë rregulluar me këtë kontratë vlejnjë dispozitat e Rregullores mbi Kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe manualit për zbatimin e saj.

Neni 16

Informacionet që përmban forma e përshkrimit të projektit dhe forma e buxhetit të projektit të cilën përfituesi e ka dorëzuar me rastin e aplikimit sipas thirrjes publike si dhe forma e buxhetit të harmonizuar sipas shumës së aprovuar nga Komisioni Vlerësues janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

Neni 17

Për çdo formë të komunikimit apo dorëzimit të njoftimit për ndryshime në kontratë dhe dorëzimin e raporteve lidhur me këtë kontratë, palët duhet të specifikojnë numrin e referencës së kontratës dhe emrin e projektit dhe të dërgojnë atë në adresën e mëposhtme:

Për ofruesin e mbështetjes financiare:

Ministria e Drejtësisë

Ndërtesa e Qeverisë Luan Haradinaj, ,

pn. Ndërtesa e ish Rilindjes 10 000 Prishtinë

E-mail: info.md@rks-gov.net

Tel: XXXXXXXX

Për përfituesin:

xx

Neni 18

Kjo kontratë hartohet në tre (3) kopje identike, nga të cilat një (1) kopje për përfituesin, si dhe dy kopje për ofruesin e mbështetjes financiare publike.

Neni 19

Kontrata hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët kontraktuese.

Vendi dhe data:

**Për ofruesin e mbështetjes
financiare publike:**

Për përfituesin:

Emri, mbiemri dhe pozita dhe
nënshkrimi i personit të autorizuar

Emri, mbiemri dhe pozita dhe
nënshkrimi i personit të autorizuar